



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226786
Datë: 12.04.2024
Numri i dokumentit: 05567910

C-IV-14-6573

Ankuesi

Z B Hani Elezit

kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit për N.SH PMN ‘Sharr’ (në likuidim), Rruga ‘Dritan Hoxha’, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 12 prill 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- HEDHET POSHTË si e pa pranueshme, Ankesa kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së.**
- Nuk caktohet taksë gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me datë 17 tetor 2014, pranë kësaj gjykate, me poste ka arritur zarfi me R-0567348, pa parashtrësë në emër të Z B në të cilën është i bashkangjitur vetëm vendimi i Autoritetit të Likuidimit.

Me 14 shkurt 2024, gjykata lëshoi urdhër për ankuesin, me të cilin ka kërkuar që brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ankuesi të parashtroj ankesën, librezën e punës si dhe prova tjera në mbështetje të ankesës. Po ashtu, ankuesi është njoftuar se nëse nuk e dorëzon ankesën, librezën e punës si dhe prova të tjera, atëherë ankesa e tij do të hedhet poshtë si e pa pranueshme.

Arsyetimi ligjor

Ankesa e ankuesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 74.2, i Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton:

Çdo kreditor i Ndërmarrjes i cili ka dorëzuar me kohë kërkesën në Agjenci dhe i cili cenohet nga një vendimi i Autoritetit të Likuidimit mund ta kundërshtojë vendimin e tillë, duke parashtruar një ankesë në Dhomën e Posaçme kundër Agjencisë brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Çdo ankesë e këtillë duhet të bazohet në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në pajtim me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ankesa duhet të jetë në pajtim me kërkesat e paragrafit 2. të nenit 27 të kësaj shtojce dhe të bashkëngjisë një kopje të vendimit ndaj të cilit është ngritur kundërshtimi.

Nenet 33 dhe 35, të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ndër të tjera rregullojnë parashtrimin e kërkesave përkatësisht ankesave dhe nisjen e procedurave në Dhomën e Posaçme. Neni 35.2 më tej përcakton se çfarë duhet të përmbaj një kërkesë apo ankesë.

Neni 36.2.2.5, i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që:

*Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse:
kërkesa/ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 të kësaj shtojce dhe është në përputhje me dispozitat e nenit 35 të kësaj shtojce.*

Neni 36.2.2.6 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh që:

*Një kërkesë/ankesë është e pranueshme nëse:
është bashkëlidhur edhe një kopje e aktit juridik kundër apo ndaj të cilit është paraqitur kërkesa/ankesa.*

Një rregullim të njëjte ishte paraparë edhe me shtojcën e Ligjit Nr.04-L-033 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përkatësisht në nenin. 25, 27, 28 dhe 70.2 të të njëjtit, si ligj i cili ka qenë në fuqi në kohën e parashtrimit të ankesës.

Në kuptim të këtyre dispozitave, gjykata vjen në përfundim se ankesa duhet të dorëzohet në gjykatë së bashku me vendimin e atakuar të Autoritetit të Likuidimit, brenda afatit 30 ditor pas pranimit të vendimit. Në këtë mënyrë, dorëzimi i ankesës nga ankuesi me të cilën e atakon

vendimin e Autoritetit të Likuidimit, është një kriter i pranueshmerisë së saj përkatësisht mosdorëzimi i ankesës nga vet ankuesi, e bën ankesën e tij të papranueshme.

Megjithatë, gjykata i ofroi edhe një mundësi ankuesit për ta plotësuar këtë kusht të pranueshme risë, ashtu që nëpërmjet urdhrit të saj të datës 14 shkurt 2024, i kërkoi dorëzimin e ankesës, librezës së punës si dhe prova të tjera në mbështetje të ankesës së tij, brenda afatit të përcaktuar në atë urdhër. Nga zyrtari i postës është konstatuar se urdhri është pranuar nga ankuesi me 16 shkurt 2024, por nuk i ka dorëzuar ankesën, librezën e punës dhe as provat që e mbështesin ankesën për pretendimet e saj.

Pra, meqenëse ankuesi dështoi në përmbushjen e kërkesës sipas urdhrit të gjykatës, gjykata vendosi të hedh poshtë ankesën e tij si të papranueshme.

Për këtë në pajtim me nenet 36.1, 36.3 dhe 74.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, Ankesa kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, hedhet poshtë si e papranueshme.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, ankuesi si palë e pasuksesshme do të mbuloj shpenzimet e procedurës.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare